



Konferenca e Përbashkët Ballkanike 2015
“Uji dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm”
Prishtinë 4-6 Nëntor 2015


Marrëdhënia midis Shoqërive UK dhe Pushtetit Lokal - Një vështrim mbi eksperiencën shqiptare

Dritan Shehaj, Përgjegjës i Sektorit Juridik
Enti Rregullator i Ujit, Shqipëri

- Sektori UK përmbledh interesat e shumë palëve:
 - ✓ pushtetit qëndror;
 - ✓ pushtetit lokal;
 - ✓ konsumatorëve;
 - ✓ operatorëve të shërbimeve,
 - ✓ donatorëve, etj.;
- Të gjitha palët kërkojnë të realizojnë interesat e saj, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejt në një sektor shumë të rëndësishëm për të gjithë

Sektori UK dhe aktorët

- Qeverisja qendrore miraton standartet dhe strategjitë;
- Qeverisja lokale - pushteti më afër konsumatorëve, ka përgjegjësinë për këto shërbime;
- Shoqëritë UK kërkojnë të ushtrojnë aktivitet fitimprurës;
- Konsumatorët kërkojnë të marrin shërbim cilësor dhe me kosto të përballueshme;



- Pushteti lokal përfaqëson nivelin më të ulët të qeverisjes dhe është pushteti më afër me qytetarin;
- Tre janë funksionet kryesore të pushtetit lokal:
 - ✓ shërbimet publike vendore (si ujësjellsi dhe kanalizimet, mbetjet e ngurta, infrastruktura lokale, etj.);
 - ✓ Shërbimet sociale (edukimi, sportet, qendrat sociale, shëndeti, etj.);
 - ✓ Planifikimi, promovimi i zhvillimit dhe kontrolli (planifikimi i zhvillimit, planifikimi urban, punësimi, rendi publik, etj.

- Në çdo rast, roli i njësisë vendore duhet të jetë tepër aktiv, dhe marrdhënia duhet të karakterizohet nga transparencja dhe llogaridhënia;
- Kjo marrdhënie duhet të jetë e tillë që të lejoje palët të realizojnë interesat e përbashkëta në raport me shërbimin;
- Kjo marrdhënie ndikon në interesin e drejtpërdrejtë të qytetarëve për një shërbim cilësor;

Periudha 1945-1990:

- Ndërmarrje që funksiononin sipas parimit të centralizimit demokratik;
- Mbas vitit 1990 filluan të riorganizohen të gjitha shërbimet;
- U plotësua kuadri ligjor përkatës për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare;

Vitet 1990 -2000:

- Të gjitha ndërmarrjet ujësjellës-kanalizime u transformuan në shoqëri tregtare sh.a;
- Pronar pushteti qendror dhe administrimi përmes ministrisë përkatëse të ekonomisë;
- Pushtetit lokal nuk gëzon asnjë kompetencë apo përgjegjësi në raport me këto shërbime;
- Decentralizimi më shumë një ide se sa një aspekt praktik;

Vitet 2000 -2010:

- U miratua ligji nr.8652, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", u hodh një hap i madh drejt decentralizimit;
- Në këtë mënyrë, ju hap rrugë fillimit të proceseve të decentralizimit të këtyre shërbimeve, dhe transferimit të tyre pranë njësive vendore;
- Hapi përmbyllës i decentralizimit u shënua në vitin 2007, kur të gjithë shoqëritë UK u transferuan pranë pushtetit lokal - VKM 660, datë 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësive të qeverisjes vendore";

- Problematikat që shoqëruan këtë proces, bënë që transferimi efektiv i të gjithë operatorëve pranë njësive vendore të zgjatej në kohë:
 - mungesën e dakortësisë me njësitë vendore për formën dhe mënyrën e transferimit të operatorve;
 - transferimi në bllok i operatorëve, pa analizuar situatën e secilit operator;
 - Formula e bashkëpronësisë;
 - Mos regjistrimi i asetëve;

- E gjithë kjo situatë çoi në një fragmentarizim të madh të sektorit dhe të shërbimeve;
- Bashkëpronësia nuk funksionoi dhe njësitë vendore organizuan në mënyrë të njëanshme shërbimin UK;
- Përveç operatorëve të mëdhenj që operonin kryesisht në zonat urbane, egzistonin 131 operatorë të vegjël, të menaxhuar nga njësitë vendore (komunat)

- Si pasojë e fragmentarizimit të NJQV-ve, buxhetet e tyre ishin të pamjaftueshëm dhe nuk mund të përballonin financime për projekte të mëdha përmirësimi infrastrukture;
- Kjo e zbehte rolin e njësive vendore, në raport me shërbimin UK, duke bërë që përmirësimi i cilësisë së shërbimit të mbetet peng i financimit të pushtetit qendror;

Jo vetëm fragmentarizimi, por edhe disa aspekte të tjera ndikuan në këtë klimë:

- ✓ Mungesa e kapaciteteve profesionale, teknike, financave - staf i reduktuar, profili profesional, etj.;
- ✓ Mungesa e vullnetit - mungesa e dëshirës së pushtetit qendror, e cila duket se nuk ka qënë e gatshme të heqë dorë nga kontrolli i investimeve;
- ✓ Konfliktet politike - interferanca e forcave qeverisëse në realizimin e përgjegjësive dhe funksioneve të pushtetit lokal.

- Kjo situatë ka penguar ndërtimin e një marrdhënie normale mes njësive vendore dhe operatorëve të shërbimit. Duke qënë që roli i njësive vendore nuk ka qënë i konsoliduar, edhe marrdhëniet me shoqërinë kanë ndjekur oshilacione të forta dhe janë zhvilluar mbi bazën e inercisë;
- Është evidentuar qartazi se vetëm 15% e NJQV-ve (që përkojnë me njësitë e mëdha vendore) kryejnë paketën e plotë të funksioneve dhe kompetencave sipas ligjit organik 8652.

- Reforma territoriale administrative ka riorganizuar të gjitha njësitë e qeverisjes vendore;
- Numri i NJQV-ve është ulur nga 375 në 61 njësi të reja vendore;
- Kjo reformë do të ndikojë edhe në riorganizimin e operatorëve dhe rritjen e rolit e ndikimit të pushtetit lokal në sektor, e si rrjedhojë edhe krijimin e një marrëdhënie më të qëndrueshme me operatorët.

- Ligji nr. 8265, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, I ndryshuar;
- Raporti Vjetor i Entit Rregullator të Ujit 2013;
- Raporti Vjetor i Entit Rregullator të Ujit 2014;
- Analiza e situates se qeverisjes vendore - Raport, www.reformaterritoriale.al
- Financing Water and sanitation at local levels – Report, Water Aid, 2008
- OECD Studies on Water Ten Years of water Sector Reform in EECA, OECD, 2011